



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

---

**PROJEKT LIGJI PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE**

**DRAFT LAW ON EXECUTION OF PENAL SANCTIONS**

**NACRT ZAKON O IZVRŠAVANJU KRIVIČNIH SANKSIJA**



<p style="text-align: center;"><b>REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton</p> <p style="text-align: center;"><b>LIGJIN PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>PJESA E PARË PJESA E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Kapitulli I</b></p> <p style="text-align: center;"><b>DISPOZITAT THEMELORE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi i ligjit</b></p> <p>Qëllimi i këtij projektligji është ekzekutimi i sanksioneve penale duke përfshirë edhe masat dhe dënimet alternative të shqiptuara në pajtim me ligjin.</p>	<p style="text-align: center;"><b>REPUBLIC OF KOSOVA ASSEMBLY</b></p> <p>In support of Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves</p> <p style="text-align: center;"><b>LAW ON EXECUTIONS OF PENAL SANCTIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>PART ONE GENERAL PART</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Chapter I</b></p> <p style="text-align: center;"><b>BASIC PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose of the Law</b></p> <p>Purpose of this draftlaw is execution of penal sanctions, including measures, alternative punishments imposed in accordance with the law</p>	<p style="text-align: center;"><b>REPUBLIKA KOSOVA SKUPŠTINA</b></p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja</p> <p style="text-align: center;"><b>ZAKONA ZA IZVRŠAVANJE KAZNENIH SANKCIJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>PRVI DEO OPŠTI DEO</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Poglavlje I</b></p> <p style="text-align: center;"><b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Svrha zakona</b></p> <p>Srha ovog nacrtzakona je izvršavanje kaznenih sankcija uključujući mere, alternativne kazne izvršene u skladu sa zakonom</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi i ligjit</b></p> <p>1. Sanksionet penale ekzekutohen në pajtim me këtë ligj.</p> <p>2. Sipas këtij ligji sanksionet penale janë dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese dhe vërejtja gjyqësore.</p> <p>3. Masat e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm ekzekutohen në institucion të veçantë në pajtim me këtë ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope of Law</b></p> <p>1. Penal sanctions shall be executed in accordance with the present Law.</p> <p>2. For the purposes of the present Law, penal sanctions are principal punishments, alternative punishments, accessory punishments and judicial admonition.</p> <p>3. Measures of mandatory rehabilitation treatment shall be executed in accordance with the present Law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Sadržina zakona</b></p> <p>1. Krivične sankcije izvršavaju se u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>2. Za potrebe ovog Zakona, krivične sankcije su glavne kazne, alternativne kazne, dopunske kazne i sudska opomena.</p> <p>3. Mere obaveznog rehabilitacionog tretmana izvršavaju se u posebnoj ustanovi u skladu sa ovim Zakonom</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b></p> <p>Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e sanksioneve penale të shqiptuara nga gjykatat vendore dhe të huaja, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b></p> <p>The provisions of the present Law shall apply to the execution of penal sanctions imposed by foreign courts in accordance with the Code of Criminal Procedure and international agreements.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b></p> <p>Odredbe ovog zakona primenjuju se na izvršavanje krivičnih sankcija koje izriču mesni i strani sudovi, u skladu sa Zakonom o krivičnom postupku i međunarodnim sporazumima.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b></p> <p>Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b></p> <p>The execution of penal sanctions shall aim at the reintegration of the convicted person into society and prepare him or her</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b></p> <p>Izvršavanje krivičnih sankcija ima za cilj resocializaciju i reintegraciju, osuđenog u društvo i da se on pripremi</p>



për jetë dhe sjellje të përgjegjshme. Ekzekutimi i sanksioneve penale po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale.

**Neni 5  
Parimet drejtuese**

1. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor a degradues.

2. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrë plotësisht të paanshme. Nuk duhet të ekzistojë diskriminim në asnjë bazë qoftë ajo e prejardhjes kombëtare a shoqërore, e racës, e ngjyrës, e gjinisë, e gjuhës, e gjendjes ekonomike dhe sociale, e bindjes politike ose e mendimit tjetër dhe e besimit fetar, e përkatësisë së një bashkësie etniko-religjioze ose e gjuhësore në Kosovë, e pasurisë, e statusit të lindjes ose e ndojnë statusi tjetër.

to conduct his or her life in a socially responsible way. The execution of penal sanctions shall also serve the purpose of protecting society by preventing the commission of further criminal offences.

**Article 5  
Guiding Principles**

1. Penal sanctions shall be executed in such a way as to assure humanity of treatment and respect for the dignity of each individual. The convicted person shall not be subject to torture or to inhuman or degrading treatment or punishment.

2. Penal sanctions shall be executed with absolute impartiality. There shall be no discrimination on any ground such as national or social origin, race, colour, gender, language, economic and social status, political or other opinion and religious beliefs, affiliation to an ethnic religious or linguistic community in Kosovo, property, birth or other status.

za život i odgovorno ponašanje. Izvršavanje krivičnih sankcija takođe služi u svrhu zaštite društva time što se sprečava činjenje drugih krivičnih dela.

**Član 5  
Rukovodeći principi**

1 Krivične sankcije izvršavaju se na način koji obezbeđuje humano postupanje i poštovanje dostojanstva svakog pojedinca. Osuđena osoba ne sme biti izložena torturi ili nehumanom i degradirajućem postupanju.

2 Krivične sankcije izvršavaju se uz apsolutnu nepristrasnost. Ne sme da postoji diskriminacija ni po kojoj osnovi, kao što su nacionalno ili socijalno poreklo, rasa, boja kože, pol, jezik, ekonomski i socijalni status, političko ili drugo mišljenje i verska ubeđenja, pripadnost nekoj etničko-religioznoj ili jezičkoj zajednici na Kosovu, imovina, rođenje ili neki drugi status.



<p>3. Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal gjithmonë respektohen të drejtat e personit të dënuar. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në atë masë që është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal në pajtim me ligjin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.</p> <p>4. Zbatimi i sanksioneve penale duhet të nxisë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrjen e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, sidomos përmes zbatimit të planit individual dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla.</p> <p>5. Qëllimi i risocializimit dhe riintegrit të personit të dënuar në bashkësi po ashtu duhet të plotësohet përmes nxitjes dhe organizimit të pjesëmarrjes së institucioneve ose të organeve publike dhe private si dhe të individëve në procesin e riintegrit.</p>	<p>3. During the execution of a penal sanction, the rights of the convicted person shall always be respected. These rights may be restricted only to the extent necessary for the execution of the penal sanction, in compliance with the applicable law and international human rights standards.</p> <p>4. The enforcement of penal sanctions and should, as far as possible, stimulate the participation of the convicted person in his or her own social reintegration, especially through the implementation of an individual plan and the cooperation of society in achieving such aims.</p> <p>5. The aim of reintegrating the convicted person into the community shall also be pursued by urging and organizing the participation of public and private institutions or bodies, as well as of individuals, in the reintegration process.</p>	<p>3. Prava osuđene osobe moraju uvek da budu poštovana tokom izvršavanja krivične sankcije. Ova prava mogu da budu ograničena samo u onolikoj meri koja je neophodna za izvršenje krivične sankcije u skladu sa važećim zakonom i međunarodnim standardima za ljudska prava.</p> <p>4. Primena krivičnih sankcija treba da, što je više moguće, stimuliše učešće osuđivane osobe za resocializaciju i reintegraciju, naročito putem realizacije pojedinačnih planova i saradnje društva u postizanju ovakvih ciljeva.</p> <p>5. Cilj resocializacije i reintegracije osuđene osobe u zajednicu postiže se takođe i podsticanjem i organizovanjem učešća javnih i privatnih institucija ili organa, kao i pojedinaca, u proces reintegracije.</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Fillimi i ekzekutimit të sanksioneve penale</b></p> <p>1. Ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi me të cilin është shqiptuar sanksioni penal e merr formën e prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore.</p> <p>2. Ekzekutimi i sanksionit penal mund të fillojë edhe para se të marrë formën e prerë vendimi me të cilin shqiptohet sanksioni penal, por vetëm në rastet kur kjo është paraparë shprehimisht me ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Commencement of execution of penal sanctions</b></p> <p>1. The execution of a penal sanction shall commence when the decision by which the penal sanction is imposed becomes final and there is no legal impediment to the execution of the penal sanction.</p> <p>2. The execution of a penal sanction may commence before the decision by which the penal sanction is imposed becomes final only exceptionally in the cases when it is expressly provided by law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Početak izvršenja krivičnih sankcija</b></p> <p>1. Izvršenje krivične sankcije počinje kada odluka kojom je izrečena krivična sankcija postane pravosnažna i ne postoji zakonska prepreka za njeno izvršenje.</p> <p>2. Izvršenje krivične sankcije može da počne pre nego što odluka kojom je krivična sankcija izrečena postane pravosnažna, i to samo u slučajevima kada je to izričito propisano zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Shtyrja dhe pezullimi i sanksionit penal</b></p> <p>Ekzekutimi i sanksionit penal mund të shtyhet ose të pezullohet sipas kushteve të parapara me ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Postponement and suspension of penal sanction</b></p> <p>The execution of a penal sanction may be stayed or suspended under conditions provided by law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Odlaganje i prekid krivičnih sankcija</b></p> <p>Izvršenje krivične sankcije može da bude odloženo ili obustavljeno pod uslovima koje propisuje zakon.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Taksat administrative për parashtrësia</b></p> <p>Për parashtrësia, veprime zyrtare dhe vendime lidhur me zbatimin e dispozitave</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Administrative fees for submissions</b></p> <p>Administrative fees shall not be paid in regard to submissions, official actions and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Administrativne takse za podneske</b></p> <p>Administrativne takse se ne plaćaju kada je reč o podnescima, službenim</p>



<p>të këtij ligji nuk paguhen taksa administrative, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Mbajtja e evidencës</b></p> <p>Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për personat ndaj të cilëve ekzekutohen sanksionet penale dhe paraburgimi, mbahen evidenca përkatëse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Mjetet financiare për ekzekutimin e sanksioneve penale</b></p> <p>1. Mjetet financiare për ekzekutimin e sanksioneve penale sigurohen nga Buxheti i Kosovës.</p> <p>2. Personi i dënuar nuk i paguan shpenzimet për ekzekutimin e sanksioneve penale, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.</p>	<p>decisions in connection with the application of the provisions of the present Law, unless otherwise provided by law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Maintenance of records</b></p> <p>In accordance with the provisions of the present Law, appropriate records shall be maintained on persons against whom penal sanctions and detention on remand are executed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Resources for the execution of penal sanctions</b></p> <p>1. Resources for the execution of penal sanctions shall be provided by the budget of Kosovo.</p> <p>2. The convicted person shall not pay the costs of executing a penal sanction, unless otherwise provided by law.</p>	<p>radnjama i odlukama u vezi sa primenjivanjem odredbi ovog Zakona, osim ako je drugačije propisano zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Vodenje evidencije</b></p> <p>U skladu sa odredbama ovog Zakona, za lica nad kojima se izvršavaju krivične sankcije i pritvor, vodi se odgovarajuća evidencija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Finasiska sredstva za izvršenje krivičnih sankcija</b></p> <p>1 Finasiska sredstva za izvršenje krivičnih sankcija bivaju obezbeđena iz Budžeta Kosova.</p> <p>2 Osuđeno lice ne plaća troškove izvršenja krivične sankcije, osim ako je drugačije propisano zakonom.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;"><b>PJESA E DYTË EKZEKUTIMI I DËNIMEVE KRYESORE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Kapitulli II</b></p> <p style="text-align: center;"><b>EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM, I DËNIMIT ME BURGIM AFATGJATË DHE I DËNIMIT ME GJOBË</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Transportimi i personave të dënuar në institucionet korrektuese</b></p> <p>1. Personat e dënuar me burgim dhe me burgim afatgjatë transportohen në institucione korrektuese për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim afatgjatë në pajtim me urdhëresën e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë.</p> <p>2. Përjashtimisht, me kërkesë të personit të dënuar, Ministria e Drejtësisë mund ta ndërrojë vendin e ekzekutimit të dënimit për arsye të justifikueshme.</p>	<p style="text-align: center;"><b>PART TWO EXECUTION OF PRINCIPAL PUNISHMENTS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Chapter II</b></p> <p style="text-align: center;"><b>EXECUTION OF IMPRISONMENT, LONG TERM IMPRISONMENT AND FINES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Transporting the convicted person to a correctional facility</b></p> <p>1. Persons sentenced to imprisonment and long term imprisonment shall be transported to correctional facilities for the execution of imprisonment and long term imprisonment in accordance with a directive issued by Ministry of Justice</p> <p>2. Exceptionally, on the request of the convicted person, the Ministry of Justice may for justifiable reasons change the place of execution of the sentence.</p>	<p style="text-align: center;"><b>DRUGI DEO IZVRŠENJE GLAVNIH KAZNI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Poglavlje II</b></p> <p style="text-align: center;"><b>IZVRŠENJE ZATVORSKE KAZNE, DUGOTRAJNE ZATVORSKE KAZNE I NOVČANIH KAZNI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Transport osuđenog lica u popravnustanovu</b></p> <p>1 Lica osuđena na kaznu zatvora i dugotrajnu zatvorsku kaznu moraju da budu prebačena u popravne ustanove radi izdržavanja kazne zatvora i dugotrajne kazne zatvora u skladu sa naredbom koju izdaje Ministarstvo Pravde.</p> <p>2 U izuzetnom slučaju, na zahtev osuđene osobe, Ministarstvo Pravde može iz opravdanih razloga da promeni mesto izdržavanja kazne.</p>
---	--	---





<b>Neni 12</b> <b>Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese</b>	<b>Article 12</b> <b>Placement of the convicted persons in the correctional facilities</b>	<b>Član 12</b> <b>Smeštanje osuđenih lica u popravne ustanove</b>
<p>1. Personi i dënuar me burgim mund të vendoset në qendrën e paraburgimit nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale nuk i kalon tre muaj.</p> <p>2. Personi i dënuar me burgim vendoset në institucionin korrektues nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale i kalon tre muaj.</p> <p>3. Personi i dënuar me burgim afatgjatë vendoset në institucionin korrektues.</p>	<p>1. A person sentenced to imprisonment may be placed in a detention centre if the duration of the imprisonment after taking account of detention on remand or other deprivation of liberty in connection with the criminal offence does not exceed three months.</p> <p>2. A person sentenced to imprisonment shall be placed in a correctional facility if the duration of the imprisonment, after taking account of detention on remand or other deprivation of liberty in connection with the criminal offence, exceeds three months.</p> <p>3. A persons sentenced to long term imprisonment shall be placed in a correctional facility.</p>	<p>1 Lice osuđeno na kaznu zatvora mođe da bude smešteno u centar za pritvor ako trajanje kazne zatvora, računajući pritvor ili drugo lišavanje slobode u vezi sa krivičnim delom, ne prelazi tri meseca.</p> <p>2 Lice osuđeno na zatvorsku kaznumora da bude smešteno u popravnu ustanovu ako trajanje kazne zatvora, računajući pritvor ili drugo lišavanje slobode u vezi sa krivičnim delom, prelazi tri meseca.</p> <p>3 Lice osuđeno na dugotrajnu zatvorsku kaznu mora da bude smešteno u popravnu ustanovu.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Veprimet që i paraprijnë dërgimit të personave të dënuar në institucionet korrektuese</b></p> <p>1. Nëse gjykata që ka marrë vendim në shkallë të parë nuk ka kompetencë për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë, ajo vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale të personit të dënuar të mbledhura gjatë procedurës penale ia dërgon gjykatës kompetente brenda tri ditëve prej ditës kur vendimi merr formën e prerë.</p> <p>2. Gjykata kompetente duhet ta fillojë procesin e dërgimit të personit të dënuar në mbajtje të dënimit me burgim ose burgim afatgjatë brenda tri ditëve nga pranimi i vendimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Actions which precede sending convicted persons to correctional facilities</b></p> <p>1. If a court that rendered the first-instance decision does not have jurisdiction to send the convicted person to serve a sentence of imprisonment or long term imprisonment, it shall send the final decision together with personal data on the convicted person collected during the criminal proceedings to the competent court within three days of the day on which the decision becomes final.</p> <p>2. Within three days of receiving the decision, the competent court should initiate the process of sending the convicted person to serve the sentence of imprisonment or long term imprisonment.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Postupci koji prethode slanju osuđenih lica u popravne ustanove</b></p> <p>1 Ako sud koji je doneo prvostepenu odluku nema nadležnost da pošalje osuđenog na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu, taj sud mora da pošalje pravosnažnu odluku zajedno sa ličnim podacima o osuđenom licu prikupljenim tokom krivičnog postupka nadležnom sudu u roku od tridana od dana kada odluka postane pravosnažna.</p> <p>2 U roku od tri dana od primanja odluke, nadležni sud pokreće postupak slanja osuđenog lica na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Kompetenca për dërgimin e personave të dënuar për mbajtje të dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë</b></p> <p>1. Gjykata komunale në vendin e së cilës personi i dënuar ka vendqëndrimin ose</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Jurisdiction to send convicted persons to serve sentences of imprisonment or long term imprisonment</b></p> <p>1. The municipal court in the place in which the convicted person has current or</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Nadležnost za slanje osuđenih lica na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajne zatvorske kazne</b></p> <p>1 Opštinski sud u mestu u kojem osuđeno lice ima prebivalište ili</p>



<p>vendbanimin në kohën kur vendimi për shqiptimin e dënimit merr formën e prerë është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë.</p> <p>2. Gjykata e njëjtë e ka këtë kompetencë edhe kur vendqëndrimi apo vendbanimi i personit të dënuar ndryshon më vonë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b></p> <p>Kur vendqëndrimi dhe vendbanimi i personit të dënuar nuk dihen, kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë është gjykata komunale që ka marrë vendim në shkallë të parë dhe nëse këtë vendim e ka marrë gjykata e qarkut, atëherë kompetente është gjykata komunale e cila gjendet në selinë e gjykatës së qarkut.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b></p> <p>1. Gjykata kompetente e urdhëron me shkrim personin e dënuar që në ditën e</p>	<p>permanent residence at the time when the decision imposing the sentence becomes final shall have jurisdiction to send the convicted person to serve a sentence of imprisonment or long term imprisonment</p> <p>2. The same court shall maintain its jurisdiction if the current or permanent residence of the convicted person subsequently changes.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b></p> <p>When the current and the permanent residence of the convicted person are unknown, the municipal court that rendered the first instance decision shall have jurisdiction to send the convicted person to serve a sentence of imprisonment or long term imprisonment and if this decision was rendered by a district court, the municipal court at the seat of the district court shall have jurisdiction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 16</b></p> <p>1. The competent court shall order the convicted person in writing to report to</p>	<p>boravište u vreme kada odluka kojom se izriče kazna postaje konačna nadležan je za slanje osuđenog lica na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu</p> <p>2 Isti sud zadržava svoju nadležnost ako prebivalište ili boravište osuđenog lica bude nakon toga promenjeno.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b></p> <p>Kada boravište i prebivalište osuđenog lica nije poznato, opštinski sud koji je doneo prvostepenu odluku ima nadležnost da pošalje osuđeno lice na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu, a ako je tu odluku doneo Okružni Sud, onda je nadležan opštinski sud koji se nalazi u sedištu u Okružni sud.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 16</b></p> <p>1. Nadležni sud izdaje pisani nalog osuđenom licu da se određenog dana</p>
--	---	--



<p>caktuar të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë.</p> <p>2. Periudha kohore ndërmjet pranimit të urdhrit dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më e shkurtër se tetë ditë dhe më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë.</p> <p>3. Gjykata kompetente e informon institucionin korrektues për datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion dhe ia dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës penale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë</b></p> <p>1. Institucioni korrektues e informon gjykatën kompetente se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit.</p> <p>2. Mbajtja e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është paraqitur në</p>	<p>the correctional facility to serve the sentence of imprisonment or long term imprisonment on a specific day.</p> <p>2. The period of time between the receipt of the order and the day of reporting shall be no less than eight days and no more than fifteen days.</p> <p>3. The competent court shall inform the correctional facility of the date on which the convicted person shall report and deliver the final decision along with personal information about the convicted person collected during the criminal proceedings.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Commencement of service of imprisonment or long term imprisonment sentence</b></p> <p>1. The correctional facility shall inform the competent court whether the convicted person reported to serve the sentence.</p> <p>2. Service of the sentence of imprisonment or long term imprisonment shall be counted from the day on which</p>	<p>javi popravnoj ustanovi na izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu</p> <p>2. Vremenski period od prijema naloga do dana za javljanje ne sme da bude kraći od osam dana niti duži od petnaest dana.</p> <p>3. Nadležni sud obaveštava popravnu ustanovu o datumu kada osuđeno lice mora da se javi u ustanovu i dostavlja konaču odluku zajedno sa ličnim podacima o osuđenom licu prikupljenim tokom krivičnog postupka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Početak izdržavanja kazne zatvora ili dugotrajne zatvorske kazne</b></p> <p>1. Popravna ustanova obaveštava nadležni sud da li se osuđeno lice javilo na izdržavanje kazne.</p> <p>2. Izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu računa se od dana kada se osuđeno lice javilo u</p>
--	---	--



<p>institucionin korrektues.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b></p> <p>1. Kur personi i dënuar i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata urdhëron që ai të sillet me forcë. Nëse personi i dënuar fshehet ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen e letërreshtimit.</p> <p>2. Mbajtja e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është privuar nga liria.</p>	<p>the convicted person reported to the correctional facility.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b></p> <p>1. If a convicted person who has been properly summoned does not report to the correctional facility, the court shall order that he or she be brought forcibly. If the convicted person hides or is at large, the court shall order the issuance of a wanted notice.</p> <p>2. Service of the sentence of imprisonment or long term imprisonment shall be counted from the day on which the convicted person is deprived of liberty.</p>	<p>popravnu ustanovu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b></p> <p>1. Ako se osuđeno lice koje je uredno pozvano ne javi u popravnu ustanovu, sud naređuje da se on prinudno dovede. Ako se osuđeno lice skriva ili je u bekstvu, sud naređuje raspisivanje poternice.</p> <p>2. Izdržavanje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu računa se od dana kada je osuđeno lice lišeno slobode.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Shpenzimet e transportimit</b></p> <p>1. Institucioni korrektues personit të dënuar ia kompenson shpenzimet e transportimit publik nga vendbanimi ose vendqëndrimi deri në institucionin korrektues.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Transportation expenses</b></p> <p>1. The correctional facility shall compensate the convicted person for public transportation expenses from the place of permanent or current residence of the convicted person to the correctional facility.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Troškovi transporta</b></p> <p>1. Popravna ustanova nadoknađuje osuđenom licu troškove javnog saobraćaja od mesta prebivališta odnosno boravišta osuđenog lica do popravne ustanove.</p>



<p>2. Personi i dënuar i cili në institucionin korrektues sillet me forcë i paguan shpenzimet.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim afatgjatë</b></p> <p>1. Ekzekutimi i dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë mund të shtyhet me kërkesë të personit të dënuar:</p> <p>1.1. Deri në shërimin e sëmundjes nëse personi i dënuar vuan nga një sëmundje e rëndë akute;</p> <p>1.2. Më së largu deri në fund të vitit të tretë të jetës së fëmijës, nëse personi i dënuar femër e ka përfunduar muajin e gjashtë të shtatëzënësisë ose e ka fëmijën më të ri se një vit;</p> <p>1.3. Më së largu deri në tre muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi ose prindi adoptues i personit të dënuar ka vdekur ose vuan</p>	<p>2. The convicted person shall pay the expenses of being brought forcibly to the correctional facility.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Postponement of execution of sentences of imprisonment and long term imprisonment</b></p> <p>1. The execution of a sentence of imprisonment or long-term imprisonment can be postponed upon the request of the convicted person:</p> <p>1.1. Until the end of an illness, if the convicted person is suffering from a serious acute illness;</p> <p>1.2. Until, at the latest, the end of the third year of life of the child, if the female convicted person has completed the sixth month of pregnancy or has a child younger than one year of age;</p> <p>1.3. Until, at the latest, three months from the day of the commencement of the stay of execution, if a spouse, a child, an adopted child, a parent or an adoptive parent of the convicted person</p>	<p>2. Osuđeno lice plaća troškove prinudnog dovođenja u popravnu ustanovu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Odlaganje izvršenja kazne zatvora i dugotrajne zatvorske kazne</b></p> <p>1. Izvršenje kazne zatvora ili dugotrajne zatvorske kazne može da bude odloženo na zahtev osuđenog lica:</p> <p>1.1. Do izlećenja bolesti, ako osuđeno lice pati od ozbiljne akutne bolesti;</p> <p>1.2. Najkasnije do navršavanja treće godine života deteta, ako je osuđeno lice ženskog pola navršilo šesti mesec trudnoće ili ima dete mlađe od godinu dana;</p> <p>1.3. Za najviše tri meseca od dana početka odlaganja izvršenja, ako je bračni drug, dete, usvojeno dete, roditelj ili usvojitelj osuđenog lica preminuo ili pati od neke ozbiljne</p>
---	--	---



<p>nga ndonjë sëmundje e rëndë;</p> <p>1.4. Më së largu deri në gjashtë muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse bashkëshortja e personit të dënuar ka për të lindur edhe tre muaj, ose nëse kanë kaluar më pak se gjashtë muaj prej ditës kur ajo ka lindur dhe nuk ka anëtar tjetër të familjes për t'i ndihmuar asaj;</p> <p>1.5. Më së largu deri në gjashtë muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse bashkëshorti ose ndonjë anëtar tjetër i shtëpisë së përbashkët të personit të dënuar ftohet me personin e dënuar që ta mbajë dënimin me burgim apo me burgim afatgjatë ose nëse ndonjëri prej tyre tashmë është në burg;</p> <p>1.6. Më së largu deri në tre muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse shtyrjen e kërkon personi i dënuar për kryerjen e punëve bujqësore ose sezonale që nuk mund të shtyhen ose</p>	<p>has died or is suffering from a serious illness;</p> <p>1.4. Until, at the latest, six months from the day of commencement of the postponement of execution, if the wife of the convicted person has three months until the day of giving birth, or if less than six months have elapsed from the day on which she gave birth and there is no other member of the household who would help her;</p> <p>1.5. Until, at the latest, six months from the day of commencement of the postponement of execution, if the spouse or some other member of the shared household of the convicted person is summoned with the convicted person to serve a sentence of imprisonment or long term imprisonment if any of them is already in prison;</p> <p>1.6. Until, at the latest, three months from the day of commencement of the postponement of execution, if the postponement is required by the convicted person for agricultural or</p>	<p>bolesti;</p> <p>1.4. Za najviše šest meseci od dana početka odlaganja izvršenja, ako je suprugi osuđenog ostalo još tri meseca do porođaja, ili ako je prošlo manje od šest meseci od dana kada se porodila i ne postoji nijedan drugi član porodice koji bi joj pomogao;</p> <p>1.5. Za najviše šest meseci od dana početka odlaganja izvršenja, ako je bračni drug ili neki drugi član zajedničkog domaćinstva osuđenog lica pozvan da sa osuđenim licem izdržava kaznu zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu, ili ako je bilo ko od njih već u zatvoru;</p> <p>1.6. Za najviše tri meseca od početka odlaganja izvršenja, ako je osuđeno lice zatražilo odlaganje zbog poljoprivrednih ili sezonskih radova koji ne mogu biti odloženi ili zbog</p>
--	--	--



<p>për punë si pasojë e ndonjë fatkeqësie dhe familja e personit të dënuar nuk ka fuqi të duhur punëtore;</p> <p>1.7. Më së largu deri në tre muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse personi i dënuar është i detyruar të kryejë punën tashmë të filluar dhe moskryerja e saj do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm;</p> <p>1.8. Më së largu deri në gjashtë muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit nëse personi i dënuar kërkon shtyrjen për përfundimin e shkollimit ose për t'iu nënshtuar provimit të cilin e ka përgatitur.</p> <p>2. Dita kur merret vendimi për shtyrjen e ekzekutimit konsiderohet dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit.</p>	<p>seasonal work which cannot be delayed or work caused by some accident and the family of the convicted person does not have the necessary manpower;</p> <p>1.7. Until, at the latest, three months from the day of commencement of the postponement of execution, if the convicted person is obliged to complete work which has already been started and considerable damage may result from the failure to complete it;</p> <p>1.8. Until, at the latest, six months from the day of commencement of the postponement of execution, if the convicted person requires a postponement to complete schooling or to take an examination for which he or she has prepared.</p> <p>2. The day on which the ruling on the postponement of execution is rendered shall be considered the day of commencement of the postponement of execution.</p>	<p>radova uzrokovanih nekom nezgodom i porodica osuđenog lica nema potrebnu radnu snagu;</p> <p>1.7. Za najviše tri meseca od dana odlaganja izvršenja ako je osuđeno lice obavezno da završi posao koji je već započeo i čije bi neizvršenje izazvalo znatnu štetu;</p> <p>1.8. Za najviše šest meseci od početka odlaganja izvršenja ako osuđeno lice zahteva odlaganje da bi završilo školovanje ili polagalo ispit koji je on spremio.</p> <p>2. Dan kada je rešenje o odlaganju izvršenja doneto smatra se danom početka odlaganja izvršenja.</p>
--	---	--





<b>Neni 21</b> <b>Procedura për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit</b>	<b>Article 21</b> <b>Procedure for postponement of execution of sentence</b>	<b>Član 21</b> <b>Postupak za odlaganje izvršenja kazne</b>
<p>1. Personi i dënuar e parashtron kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri ditëve nga pranimi i urdhrit për mbajtjen e dënimit.</p> <p>2. Nëse sëmundja e rëndë akute e personit të dënuar ose vdekja e bashkëshortit të tij, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit ose prindit adoptues paraqitet pas kalimit të periudhës prej tri ditëve, kërkesa mund të parashtrohet deri në ditën kur personi i dënuar duhet të paraqitet për mbajtjen e dënimit.</p> <p>3. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit duhet të përmbajë arsyet e shtyrjes, provat që mbështesin shtyrjen dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet shtyrja.</p>	<p>1. A convicted person shall submit a request for a postponement of execution of a sentence within three days of receiving an order for serving the sentence.</p> <p>2. If a serious acute illness of the convicted person or the death of his or her spouse, child, an adopted child, parent or adoptive parent occurs after the expiry of the three day period, the request may be submitted up to the day on which the convicted person is required to report to serve the sentence.</p> <p>3. The request for a postponement of execution shall cite the reasons for the postponement, shall enclose evidence that supports the reasons and shall state the period of time for which the postponement is requested.</p>	<p>1. Osuđeno lice mora da preda zahtev za odlaganje izvršenja kazne u roku od tri dana od prijema odluke o izdržavanju kazne.</p> <p>2. Ako nakon isteka perioda od tri dana dođe do ozbiljne akutne bolesti osuđenog lica ili smrti njegovog supružnika, deteta, usvojenog deteta, roditelja ili usvojitelja, zahtev može da bude podnet nakon isteka tri dana, zahtev se može podneti do dana kad je osuđeno lice dužno da se javi na izdržavanje kazne.</p> <p>3. U zahtevu za odlaganje izvršenja moraju da budu navedeni razlozi za odlaganje, dokazi koji potkrepljuju razloge odlaganja i naveden vremenski period za koji se traži odlaganje.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b></p> <p>1. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit i parashtrohet kryetarit të gjykatës kompetente komunale.</p> <p>2. Nëse provat nuk i bashkëngjiten kërkesës, kryetari i gjykatës komunale e urdhëron personin e dënuar që provat t'i parashtrorë brenda tetë ditëve dhe e paralajmëron se në të kundërtën kërkesa e tij do të refuzohet.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b></p> <p>1. The request for a postponement of execution of a sentence shall be submitted to the president of the competent municipal court.</p> <p>2. If evidence is not enclosed with the request, the president of the municipal court shall order the convicted person to submit the evidence within eight days, and shall warn him or her that the failure to do so will result in the denial of the request.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b></p> <p>1. Zahtev za odlaganje izvršenja podnosi se predsedniku nadležnog opštinskog suda.</p> <p>2. Ako uz zahtev nisu priloženi dokazi, predsednik opštinskog suda naređuje osuđenom licu da podnese dokaze u roku od osam dana i upozorava ga da će u suprotnom njegov zahtev biti odbijen.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b></p> <p>1. Kryetari i gjykatës kompetente komunale vendos lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri ditëve nga pranimi i kërkesës. Para marrjes së vendimit gjykata mund të zbatojë hetime të nevojshme për vërtetimin e fakteve të parashtruara në kërkesë.</p> <p>2. Kryetari i gjykatës kompetente komunale e hudh kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit nëse ajo nuk është parashtruar brenda periudhës së paraparë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b></p> <p>1. The president of the competent municipal court shall decide on the request for a postponement of execution of a sentence within three days of receipt of the request. Before rendering the ruling, the court may carry out necessary investigations in order to confirm the facts stated in the request.</p> <p>2. The president of the competent municipal court shall dismiss a request for a postponement of execution of a sentence which is not submitted within the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b></p> <p>1. Predsednik nadležnog opštinskog suda odlučuje o zahtevu za odlaganje izvršenja kazne u roku od tri dana od prijema zahteva. Pre nego što donese rešenje sud može da sprovede potrebnu istragu kako bi utvrdio činjenice navedene u zahtevu.</p> <p>2. Predsednik nadležnog opštinskog suda odbacuje zahtev za odlaganje izvršenja kazne koji nije podnet u propisanom vremenskom periodu,</p>



<p>kohore dhe nëse është dorëzuar nga personi i paautorizuar ose nëse për të nuk janë dorëzuar provat që e mbështesin atë brenda periudhës së paraparë kohore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b></p> <p>1. Kundër aktvendimit të shkallës së parë personi i dënuar mund t'i parashtrojë ankesë kryetarit të gjykatës kompetente të qarkut brenda tri ditëve nga pranimi i aktvendimit.</p> <p>2. Kryetari i Gjykatës së Qarkut vendos për ankesën brenda tri ditëve nga pranimi i saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b></p> <p>1. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit e pezullon ekzekutimin e dënimit derisa të merret vendim i formës së prerë lidhur me kërkesën.</p> <p>2. Kryetari i gjykatës kompetente komunale i cili pas parashtrimit të dytë të kërkesës konstaton se e drejta në ankesë është keqpërdorur vendos që ankesa të</p>	<p>prescribed period of time, which is submitted by an unauthorized person, or for which the supporting evidence is not submitted within the prescribed period of time.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b></p> <p>1. A convicted person may file an appeal against a first instance ruling to the president of the competent district court within three days of receipt of the ruling.</p> <p>2. The president of the district court shall decide on the appeal within three days of its receipt.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b></p> <p>1. The request for a postponement of execution postpones the execution of the sentence until the final ruling on the request.</p> <p>2. The president of competent municipal court who, after the second submission of a request establishes that the right to request a postponement has been abused,</p>	<p>zahtev koji je podnelo neovlašćeno lice ili zahtev uz koji potkrepljujući dokazi nisu podneti u propisanom roku.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b></p> <p>1. Osuđeno lice može da uloži žalbu na prvostepeno rešenje predsedniku nadležnog okružnog suda, u roku od tri dana od prijema rešenja.</p> <p>2. Predsednik Okružnog Suda odlučuje o žalbi u roku od tri dana od njenog prijema.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 25</b></p> <p>1. Zahtev za odlaganje izvršenja zadržva izvršenje kazne sve do pravosnažne odluke u vezi zahteva.</p> <p>2. Predsednik nadležnog opštinskog suda koji nakon drugog podnošenja zahteva ustanovi da je pravo na zahtevanje odlaganja zloupotrebjeno,</p>
--	---	--



<p>mos e shtyejë ekzekutimin e vendimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b></p> <p>Personi i dënuar, të cilit i është shtyrë ekzekutimi i dënimit për shkak të sëmundjes së rëndë akute, duhet të dorëzojë raport mbi gjendjen e tij shëndetësore të lëshuar nga institucioni mjekësor ku është duke u trajtuar një herë në tre muaj ose, me kërkesë gjykatës kompetente, edhe më shpesh.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Revokimi dhe ndërprerja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit</b></p> <p>1. Kryetari i gjykatës kompetente komunale e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit nëse më vonë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar ose kanë pushuar së ekzistuari, ose personi i dënuar e ka shfrytëzuar periudhën e shtyrjes për qëllime të tjera e jo për ato për të cilat është lejuar.</p>	<p>shall decide that an appeal shall not postponement the execution of the decision.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b></p> <p>A convicted person for whom the execution of a sentence has been postponed due to serious acute illness must submit a report on his or her state of health by the medical institution where he or she is being treated once every three months or, on the request of the competent court, more frequently.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Revocation and termination of the postponement of execution of a sentence</b></p> <p>1. The president of the competent municipal court shall revoke the postponement of execution of a sentence if it is subsequently established that the reasons for granting the postponement did not exist or have ceased to exist, or that the convicted person has used the period of the postponement for a purpose other than that for which it was granted.</p>	<p>donosi odluku da žalba ne odlaže izvršenje odluke.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b></p> <p>Osuđeno lice kojem je odloženo izvršenje kazne zbog ozbiljne akutne bolesti mora da podnese izveštaj medicinske institucije gde se on nalazi na lečenju o svom zdravstvenom stanju jednom u tri meseca ili češće na zahtev nadležnog suda.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Opoziv i prekid odlaganja izvršenja kazne</b></p> <p>1. Predsednik nadležnog opštinskog suda opoziva odlaganje izvršenja kazne ako se naknadno ustanovi da razlozi za odobravanje odlaganja nisu postojali ili su prestali da postoje, ili da je osuđeno lice iskoristilo period odlaganja u neku drugu svrhu a ne u onu zbog koje mu je dodeljeno.</p>
---	--	--



<p>2. Nëse shtyrja i është lejuar gruas shtatzënë, fëmija i së cilës nuk ka lindur i gjallë, shtyrja ndërpritet gjashtë muaj pas lindjes dhe nëse fëmija vdes pas lindjes, shtyrja ndërpritet gjashtë muaj pas vdekjes së fëmijës.</p> <p>3. Nëse shtyrja i është lejuar nënës së fëmijës më të ri se një vit i cili vdes, shtyrja ndërpritet gjashtë muaj pas vdekjes së fëmijës.</p>	<p>2. If the postponement has been granted to a pregnant woman whose child is not born alive, the postponement shall be terminated six months after the delivery, and if the child dies after the delivery the postponement shall be terminated six months after the death of the child.</p> <p>3. If a postponement has been granted to a mother of a child younger than one year of age who dies, the postponement shall be terminated six months after the death of the child.</p>	<p>2. Ako je odlaganje odobreno trudnici koja potom rodi mrtvo dete odlaganje biva prekinuto šest meseci posle porođaja, a ako dete umre posle porođaja, odlaganje biva prekinuto nakon šest meseci od smrti deteta.</p> <p>3. Ako je odlaganje odobreno majci deteta mlađeg od godinu dana koje zatim umre, odlaganje biva prekinuto nakon šest meseci od smrti deteta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b></p> <p>1. Personi i dënuar ka të drejtë ankese kundër aktvendimit për revokimin ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit, në kushte të njëjta si edhe kundër aktvendimit në bazë të të cilit është vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje.</p> <p>2. Ankesa e shtynë ekzekutimin e aktvendimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b></p> <p>1. The convicted person has the right to appeal against a ruling on the revocation or termination of the postponement of execution of sentence under the same conditions as against a ruling by which a request for a postponement is decided upon.</p> <p>2. The appeal postpones the execution of the ruling.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b></p> <p>1. Osuđeno lice ima pravo žalbe na rešenje o opozivu i prekidu odlaganja izvršenja kazne pod istim uslovima kao i na rešenje kojim je odlučeno o zahtevu za odlaganje.</p> <p>2. Žalba odlaže izvršenje rešenja.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Shtyrja e ekzekutimit lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike</b></p> <p>1. Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për rishikimin e procedurës penale të parashtruar në favor të personit të dënuar mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë edhe para hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale.</p> <p>2. Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit, varësisht nga përmbajtja e kërkesës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Postponement of execution in regard to extraordinary legal remedies</b></p> <p>1. The court that decides on a request for reopening criminal proceedings submitted in favour of a convicted person may postpone the execution of a sentence of imprisonment or long term imprisonment, even before the entry into force of the ruling allowing the reopening of criminal proceedings.</p> <p>2. The court that decides on a request for the extraordinary mitigation of punishment may postpone the execution of sentence, depending on the content of the request.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Odlaganje izvršenja u vezi sa vanrednim pravnim lekovima</b></p> <p>1. Sud koji odlučuje o zahtevu za ponavljanje krivičnog postupka podnetog u korist osuđenog lica može da odloži izvršenje kazne zatvora ili dugotrajnu zatvorsku kaznu, čak i pre nego što rešenje kojim se dozvoljava ponavljanje krivičnog postupka stupi na snagu.</p> <p>2. Sud koji odlučuje o zahtevu za vanredno ublažavanje kazne može da odloži izvršavanje kazne zatvora u zavisnosti od sadržaja zahteva.</p>
